



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

Nr. 40 datë 29.03.2018

### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.59, DATË 30.12.2015 TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/ 1.3, shkronja “b”, nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja “f” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 113 të ligjit nr. 44/ 2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 5, shkronja “a” të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; vendimit nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, i ndryshuar; vendimit nr. 438, datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore”; vendimit nr. 28, datë 23.05.2016 të Këshillit Bashkiak “Për kalimin e funksioneve të Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Ujitjes dhe Kullimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, si dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, Tiranë,

## V E N D O S I:

Në vendimin nr. 59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika II.e.1 “Tarifa për Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore”, shfuqizohet
2. Në pikën II.e.2 “Tarifa për Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, bëhet kjo shtesë më poshtë

“Tarifa për shitjen e druve të zjarrit:

Çmimi për m<sup>3</sup> shitje dru zjarri 7 000 lekë/m<sup>3</sup>

3. Në pikën II.e.5 “Tarifa për Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

a. Pika 1 dhe 2 shfuqizohen dhe bashkohen në një pikë të vetme, të riformuluara si më poshtë:

“Përfitojnë reduktim të detyrimit mujor ose shërbim pa pagesë kategoritë e mëposhtme, riformulohet si më poshtë :

**1. Familje në nevojë si më poshtë përfitojnë shërbim pa pagesë :**

1.1 Fëmijë me statusin e jetimit.

1.2 Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit.

1.3 Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.

1.4 Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.

1.5 Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

1.6 Fëmijët e familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës.

1.7 Fëmijët e familjeve, ku kujdestari ligjor i fëmijës, është i divorcuar ose i ve, (sipas certifikatës së gjendjes familjare), por që është në/nën pagën minimale në shkallë, vërtetuar me dokumentacionin përkatës.

4. Vendimi nr. 14, datë 31.01.2018 i Këshillit Bashkiak “Për një shtesë në vendimin nr. 59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” të ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**